



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 27

Datë 17.06. 2021

KONTRATË PROKURIMI Nr 14

Komuna e Malishevës, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;
dhe

Auto Shtëpia „Siqani” Shpk me seli në Prishtinë me Nr biznesi 811493155

(në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

FURNIZIMI ME NJË AUTOAMBULANC PËR NEVOJAT E QKMF-SË "DR.SHPËTIM ROBAJ" NË MALISHEVË
me numër identifikues: 62500.21.035.121.

Neni 1 Lënda

1.7 Lënda e kontratës është kryerja e furnizimeve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

FURNIZIMI ME NJË AUTOAMBULANC PËR NEVOJAT E QKMF-SË "DR.SHPËTIM ROBAJ" NË MALISHEVË

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i furnizimeve është : **38,900.00€ (tridhjetëetëtmijëenëntëqindëeuro) Euro.**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.8 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4

Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në katëra origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Elod Siqani
Pozita:	Menagjer i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	15.06.2017	Data:	17.06.2017
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria ekzekutimit	9.1	10% e vleres së kontrates .
Sigurimi	10.1	<i>[Specifikoni kërkesat specifike të sigurimit]</i>
Programi ekzekutimit	11	
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Të gjitha i perkasin OE
Menaxheri i kontratës	13.1	Menaxhimi i kontrates do të bëhet nga zyrtari i drejtoris së Shëndetësis z.Arben Paqarizi i caktuar me vendim nga ZKA i AK-së.
Pranimi furnizimit	14.1	Pranimi i furnizimit me autoambulancë do të behet nga një komision i caktuar nga ZKA i AK vetem mbas testimit te autoambulances .
Cilësia furnizimeve	18.2	Autoambulanca duhet të jetë në cilësi të kerkuar sipas specifikacionit te ofertës. Nese autoambulanca nuk është në cilesi dhe sipas specifikave te cekura ne specifikacionin e ofertës do të i kthehet OE dhe shpenzimet e bera do të bien në llogari të OE.
Pagesa	20.1	Obligohet AK që mbasi ta e pranon raportin per pranim të autoambulances nga komisioni perkates i caktuar nga ZKA i AK dhe faturen nga operatori ekonomik të ia paguaj shumen sipas nenit 2 dhe 2.1 të kesaj kontrate.

Dorëzimi	21.3	Furnizimi me autoambulancë do të kryhet në afatë prej katërdhjetëepesë (45) ditësh që nga dita e nënshkrimit të kontratës.
Obligimet e garancionit	24.1	Autoambulanca ka garancion katër (4) vite në motorr pakufizim në kilometra dhe dymbdhjetë (12) vite në karoceri kunder korozionit nga dita e pranimit nga komisioni i caktuar nga ZKA i AK. Kriter për garancion është : Servisimi i automjetit duhet të kryhet çdo 10,000 (dhjetëmijë) kilometra ose mbrenda një viti duhet të kryhet servisimi edhe nese nuk behen kilometrat sipas intervalit të caktuar nga prodhuesi. Servisimi duhet të kryhet në servis të autorizuar nga prodhuesi opel.
Vonesat në ekzekutim	24.5	Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej furnizimin brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
Shërbimet pas shitjes	25.1	<i>[Jepni detajet e shërbimit pas shitjes që Furnizuesi duhet të siguroj dhe përcaktoj raportin e sigurisë së ekzekutimit të caktuar për këtë aktivitet]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<i>[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE
FURNIZIM ME AUTOAMBULANCË PËR QKMF Dr. SHPETIM ROBAJ MALISHEVË

PJESA<Nr>									
NR.I ART.	PËRSHKRIMI	NJESIA MATESE	SASIA	ÇMIMI PER NJESI PA TVSH €	TVSH (%)	ÇMIMI PER NJESI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €	VENDI I ORIGJINES	
	AUTO AMBULANCË								
	Specifikacionet teknike: Motori: Dizel Standardi EU, min. EURO 6 Viti I prodhimit 2021 Kilometra të kaluara : 00 Vëllimi I motorit: 2.0-2.5 cm3 Fuqia e motorit 122 – 150KF Ndërruesi manual I shpejtësisë : 6+R (lëvizjambropa) Tërheqja: E përparme Numri I dymve: dy (2) dym teperparme, nje (1) dym anësore rrëshqitese në anën e djathtë me xham levizës, një (1) derë dykrahëshe mbrapa Numri I uleseve ne kabinen e vozitesit: min. 1+1 Dimensionet: Gjatësia: min 5309mm – 6.200mm Lartësia: min. 1877mm – 2000mm Gjerësia (pa retrovizore): Min 1920mm Ngjyra e automjetit: E bardhë	COPË	1	36.018.52	2.881.48	38.900.00	38.900.00	EUROPË	



